



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3603 Prot

Vlorë, më 20-02 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2026

PËR
PËRCAKTIMIN E FUNKSIONIMIT TË KOPSHTIT “MUSTAFA QEMAL ATATURK”
ORIKUM NË SHËRBIM ME USHQIM DHE OFRIMIN E SHËRBIMIT TË
PËRKUJDESJES PËR GRUPMOSHËN 0-3 VJEÇ

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 113, Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 54 pika ç, d dhe dh, të Kreut IX, neni 64 pika c të Kreut X, Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKB-në nr. 98 datë 27.11.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2026” VKB-në nr. 100 datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026” dhe Udhëzimin nr. 14, datë 10.7.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”;

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e funksionimit të kopshtit “Mustafa Qemal Ataturk” Orikum në shërbim me ushqim.
2. Të miratohet shtesa prej 7 punonjësish në numrin e punonjësve të Bashkisë për të garantuar funksionimin e shërbimit me ushqim, si më poshtë:
 - 4 edukatore;
 - 1 kuzhinierë;
 - 1 ndihmëse kuzhinierë;
 - 1 sanitare;

Pozicioni	Shtesa për pozicion
Edukatore	58,000
Kuzhinierë	47,000
Ndihmës kuzhinierë	47,000
Sanitare	47,000

3. Të miratohet hapja e shërbimit të përkujdesjes (Çerdhe) për grupmoshën 0-3 vjeç në godinën e Kopshtit “Mustafa Qemal Atatürk” Orikum.
4. Të miratohet shtesa prej 4 punonjësish në numrin e punonjësve të Bashkisë, për të garantuar funksionimin e çerdhes, si më poshtë:
 - 1 Përgjegjës (Kujdestar)
 - 1 kujdestare;
 - 1 kuzhinierë;
 - 1 sanitare;

Pozicioni	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	98,000
Kujdestare	60,000
Kuzhinierë	47,000
Sanitare	47,000

5. Fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve operative do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
7. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETAR
 Brunilda Mersini




REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

Nr 3603 prot

Vlorë, më 2002 2026

RELACION

PËR KALIMIN E KOPSHTIT “MUSTAFA QEMAL ATATURK” NË KOPSHT ME USHQIM DHE HAPJEN E SHËRBIMIT TË ÇERDHESE NË TË NJËJTËN GODINË

Në Kopshtin “Mustafa Qemal Ataturk”, për vitin mësimor 2025–2026 janë të regjistruar gjithsej 58 fëmijë, të organizuar në pesë grupe sipas grupmoshave, konkretisht:

- Gr. IA/B me 19 fëmijë,
- Gr. IIA/B me 16 fëmijë
- Gr. III me 23 fëmijë.

Aktualisht, procesi edukativ zhvillohet pa shërbim ushqimi (pa ngrënie), me orar të reduktuar 07:30–13:30. Struktura organizative përbëhet nga 1 drejtues, 4 edukatore dhe 1 sanitare, staf i mjaftueshëm për funksionimin në kushtet aktuale, me 58 fëmijë dhe pa shërbim ushqimi.

Godina e kopshtit është dykatëshe dhe e organizuar si mëposhtë vijon:

Në katin e parë ndodhen dy klasa (secila klasë e ndarë në dy ambiente dhe tualet) zyra e drejtorit, një ambient për mbledhje, tualeti i stafit dhe korridori lidhës. Në katin e dytë ndodhen tre klasa (secila klasë e ndarë në dy ambiente dhe tualet) dhe korridori përkatës. Kati i parë ka 2 ballkone, kati i dytë ka 1 ballkon. Kopshti është i rrethuar, ka oborr të gjelbëruar ku ka edhe kënd lojrash. Ngrohja realizohet nëpërmjet sistemit të kaldajës funksional gjatë sezonit dimëror.

Gjithashtu, janë realizuar 100 pyetësorë me prindër të fëmijëve që aktualisht frekuentojnë kopshtin, si dhe me qytetarë të Njesisë Administrative Orikum me qëllim vlerësimin e interesit për regjistrim në kopsht me ushqim dhe çerdhe.

Nga analiza e këtyre pyetësorëve rezulton se 100% e prindërve të pyetur shprehen të interesuar për regjistrimin e fëmijëve, çka dëshmon ekzistencën e një kërkesë reale dhe të qënësishme nga komuniteti për zgjerimin e shërbimeve.

Duke marrë në konsideratë 58 fëmijët aktualë të kopshtit pa ushqim dhe numrit të lindjeve vlerësojmë si tepër të domosdoshme kalimin e kopshtit në sistem me ushqim .

Megjithatë, për organizimin e kopshtit me ushqim kërkohet plotësimi i standardeve sipas VKM 159 datë 01.03.2017 **“Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”** dhe strukturës së personelit, si më poshtë:

Për kopshtin me ushqim:

1 kuzhinierë;

1 ndihmëse kuzhinierë;

1 sanitare shtesë.

4 edukatore

Për të garantuar funksionim të plotë brenda standardeve ligjore dhe kushteve optimale për fëmijët, kërkohet strukturimi i brendshëm i godinës, organizimi i ambienteve për funksionimin e kopshtit me ushqim që do të realizohet në përputhje me standardet infrastrukturore dhe higjeno-sanitare në fuqi.

Përcaktimi i ambientit të kuzhinës, ndarja funksionale e hapësirave të kopshtit si dhe riorganizimi i hyrjes dhe qarkullimit të brendshëm do të bëhen mbi bazën e vlerësimit teknik nga zyra kompetente përkatëse, me qëllim garantimin e respektimit të kriterëve të sigurisë, higjienës dhe standardeve për sipërfaqe për fëmijë. Bashkëlidhur keni edhe fotot e plan vendosjes.

Në përfundim, vlerësohet se godina e Kopshti “Mustafa Qemal Atatürk” plotëson kushtet për kalimin nga kopsht pa ushqim në kopsht me ushqim brenda kapacitetit të lejuar, me kusht plotësimin e strukturës së personelit dhe realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme teknike dhe të sigurisë.

Për hapjen e shërbimit të çerdhes për moshën 0–3 vjeç në Njësinë Administrative Orikum

Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve sociale dhe mbështetjes së familjeve të reja në Njësinë Administrative Orikum kërkohet hapja e shërbimit të çerdhes për fëmijët e moshës 0–3 vjeç, si dhe miratimin e strukturës përkatëse të personelit.

Qëllimi i këtij propozimi është krijimi i një shërbimi të specializuar për kujdesin, edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve të moshës 0–3 vjeç, duke garantuar standarde bashkëkohore sigurie, higjiene dhe zhvillimi psiko-social, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Trendit në rritje i numrit të lindjeve dhe kërkesës për shërbime të kujdesit ditor në Njësinë Administrative Orikum ka sjellë nevojën për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese.

Të dhënat nga Qendra Shëndetësore Orikum – Fëmijët e vaksinuar 0–3 vjeç (2025)

Sipas të dhënave në Njësine Administrative Orikum, për vitin 2025, numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeç të cilët kryejnë vaksinimin dhe jetojnë në Njësine Administrative Orikum është si më poshtë:

Mosha 0-1 vjeç: 12 fëmijë

Mosha 1-2 vjeç: 23 fëmijë

Mosha 2-3 vjeç: 17 fëmijë

Totali: 52 fëmijë

Kjo tregon se në Njësine Administrative Orikum ka 52 fëmijë 0-3 vjeç, të cilët mund të jenë potencialisht pjesë e një çerdheje.

Gjithashtu hapja e çerdhes Njësine Administrative Orikum do të:

- Mbështesë prindërit në balancimin e jetës familjare dhe asaj profesionale;
- Garantojë kujdes të specializuar për fëmijët në vitet e para të jetës;
- Kontribuojë në zhvillimin e hershëm edukativ dhe social të fëmijëve;
- Përmirësojë aksesin në shërbime sociale cilësore në nivel vendor.

Shërbimi do të ofrohet në të njëjtën godinë.

Për funksionimin normal dhe cilësor të çerdhes propozohet miratimi i një strukture me 4 (katër) punonjës, konkretisht:

1 (një) kujdestare, (përgjegjëse) për mbarëvajtjen administrative, pedagogjike dhe higjeno-sanitare të institucionit të kujdesit për fëmijët e moshës 0–3 vjeç.

1 (një) kujdestare për kujdesin, edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve;

1 (një) kuzhinierë për përgatitjen e ushqimit sipas normave ushqimore për moshën 0–3 vjeç;

1 (një) sanitare për mirëmbajtjen e higjienës dhe ambienteve.

Pas miratimit në parim, Bashkia Vlorë do të angazhohet në bazë të organizimit të brendshëm institucional për ngritjen e grupeve të punës për përshtatjen e infrastrukturës sipas standardeve të përcaktuara në ligj.

Konceptoi: B.Hoxha

A.Zekaj


Pranoi: M.Selmanaj

Miratoi: L.Nebiu


Kryetar

Brunilda Mersini


PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE (EKZISTUESE)



PLANIMETRIA E KATIT TË PARË (EKZISTUESE)



PLANIMETRIA E MOBILIMIT E KATI PËRDHE (SIPAS PARASHIKIMIT TË NDËRRHYRJES)



K.0
sip = 380 m²